



HAPJA E ZYRËS NË KOSOVË

Mbështetës të aktivitetit:



PËRMBAJTJA

- Aktivitetet e UBSHGJ 4
- Statistika/Kosovë 7
- Termi i këtij numri 12
- Statistika/Shqipëri 13
- Statistika/Gjermani 14
- Raporti i KE për Kosovën (përmbledhje) 16
- Përfitimet e anëtarëve 17
- Arsyet për të investuar në Kosovë 18
- Profili i anëtarëve 20

*“Bëni atë që mundeni,
me atë që keni,
aty ku jeni”.*

Theodore Roosevelt

ME KËNAQËSI

MIRËPRET

ANËTARËT E RI TË UNIONIT TË BIZNESEVE SHQIPTARO-GJERMANE



PREMIUM



GOLD



zeropositive



ME KËNAQËSI

MIRËPRET

ANËTARËT E RI TË UNIONIT TË BIZNESEVE SHQIPTARO-GJERMANE



SILBER



BRONZE



Loni Dekor



AKTIVITETET E UBSHGJ

Unioni shënon hapjen e Zyrës në Kosovë



Më 24 nëntor 2023, Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane organizoi një pritje me rastin e promovimit të hapjes së zyrës së tij në Kosovë. Në këtë ngjarje morën pjesë qindra biznese nga Gjermania e Kosova, përfaqësues të lartë të institucioneve, organizata vendore e ndërkombëtare dhe miq të Unionit. Në emër të Unionit, të pranishmëve iu drejtua kryetari Viqa. Duke shpalosur historikun e Unionit, ai u shpreh: *“Ishin dy qëllime kryesore të cilat qëndronin në themelin e idesë për krijimin e Unionit: i pari, promovimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit ndërmjet bizneseve shqiptare në Gjermani; dhe qëllimi i dytë, nxitja dhe lehtësimi i investimeve nga Gjermania në Kosovë. Me kalimin e kohës, lindi nevoja e angazhimit tonë edhe për t’i ndihmuar kompanitë nga Kosova që t’i eksportojnë prodhimet dhe shërbimet e tyre në tregun gjerman”.*



Në vazhdim, z.Nazmi Vija i foli edhe për kontributin shumëdimensional të Unionit, si: mundësimi i bashkëpunimit midis kompanive, nxitja dhe lehtësimi i investimeve të jashtme në Kosovë, hapja e rrugëve për eksport të produkteve të Kosovës në Gjermani, ndihma ndaj bizneseve me pronare gra, ndarja e bursave për studentë, mundësimi i shkollimit profesional në Gjermani për të rinjtë nga Kosova, ndihma për komunat e vërshuara nga të reshurat, sjellja në Kosovë e testeve në kohën e pandemisë Covid-19, si dhe shumë angazhime tjera në të mirë të ekonomisë dhe shoqërisë.

Po ashtu, z.Vija foli edhe për shumë projekte të Unionit në të ardhmen, të cilat do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në ekonominë e Kosovës, prodhuesit dhe ofruesit e shërbimeve, si dhe të rinjtë me ide kreative. Platforma digjitale, showroom-i virtual, showroom-i fizik në Gjermani, Pandiri i Projekteve dhe zonat ekonomike, janë vetëm disa prej tyre.

Në fund, kryetari Vija i falënderoi të gjitha bizneset, institucionet shtetërore, organizatat vendore e ndërkombëtare, por edhe individët, që kanë kontribuar në lindjen, zhvillimin dhe rritjen e Unionit, si dhe i ftoi ata që të jenë pjesë e këtyre projekteve të mëdha me interes të përgjithshëm.

Të pranishmëve iu drejtua edhe Kryeministri i Kosovës, z.Albin Kurti, Kryetari i Kryeqytetit, z.Përparim Rama, Ministria e MPJD, znj.Donika Gërvalla, zv.Ambasadori gjerman, z.Matthias Konrad, Kryetari i Nderit i UBSHGJ, z.Lazim Destani, dhe ish-Kryetari i UBSHGJ, z.Ejup Berisha.



Albin Kurti



Përparim Rama



Donika Gërvalla Schwarz



Matthias Konrad



Lazim Destani



Ejup Berisha

Unioni organizon aksionin “ANËTARI PËR ANËTARIN”

ANËTARI PËR ANËTARIN ZBRITJE		
	DYER, DRTARE, KUZHINA, MOBILIE	5%
	BACI TOWERS APARTAMENTE	5%
	VENTILUM, KLIMATIZIM, TERMOIZOLIM	12%
	RESTORANT	5%
	STUDIO ARKITEKTURE	10%
	FASADER, MOLER KNAUF	5%
	KUZHINA MOBILIE	15%
	HAPJA E LLOGARISË TRANSFERI I MUJTEVE DHE PRODUKTE TJERA	KUSHTË SPECIALE
	KUZHINA MOBILIE	15%
	APARTAMENTE	5%
	NOJFRA FASADA ETJ.	5-20%
	KONTROLLAT SISTEMATIKE PËR PUNËTORË ANALIZAT LABORATORIKE CERTIFIKATAT SHËNDETSORE KONTROLLAT TJERA	20%
	MOZAIKË, MOBILIE DIZAJN INTERIERI	20%
 UNION BUSINESS Albanisch & Deutsch		

Me rastin e festave të fundvitit, Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane ka ndërmarrë një iniciativë për aktivizimin e shërbimit ANËTARI PËR ANËTARIN. Me këtë rast, 13 biznese anëtare të Unionit me bazë në Kosovë, kanë ofruar zbritje speciale për të gjithë anëtarët e Unionit (nga Gjermania e Kosova).

Aksioni ka filluar nga 20 dhjetori i vitit 2023 dhe do të zgjas deri më 31 janar 2024.

Duke qenë në shërbim të anëtarëve të tij, Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, në vazhdimësi, do të ndërmarr iniciativë të ndryshme në funksion të nxitjes së bashkëpunimit midis anëtarëve, me qëllim zhvillimin e tyre, rritjen e Unionit dhe ndikimin në ekonominë e vendit.

STATISTIKA / KOSOVË

Popullsia

2011



1,739,825

Paga

2022



521 €

Papunësia

2022/TM4



11.8 %

BPV

2023/TM3



2.97 %


Inflacioni

2023M11



2.9 %

Bruto Produkti Vendor (BPV): TM1/2021 - TM3/2023



	2023/TM3	2023/TM2	2023/TM1	2022/TM4	2022/TM3	2022/TM2	2022/TM1	2021/TM4
Rritja reale e BPV-së (%)	2,97	2,42	3,85	4,78	4,30	3,33	4,70	7,38

(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Tregtia e jashtme


Eksporti sipas Broad Economic Categories (BEC) - (TM3/2023)

Vlera në (000)

Forma tabelare:

	1: Ushqim dhe pije	2: Furnizimet industriale të paspecifikuara diku tjetër	3: Karburantët dhe lubrifikantët	4: Mallrat kapitale (përveç paisjeve të transportit) me pjesët dhe aksesoret e saj	5: Paisjet e transportit me pjesët dhe aksesoret e tyre	6: Mallrat e konsumit të paspecifikuara diku tjetër	7: Mallrat të cilat nuk janë të specifikuara diku tjetër
2023M09	12 966,025	33 006,110	2 547,767	3 422,083	690,678	25 742,854	20,500
2023M08	13 982,701	25 801,915	536,831	3 885,488	654,827	22 396,600	83,258
2023M07	12 788,981	29 691,689	761,244	2 825,053	750,994	20 437,607	64,000

Forma grafike:



(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)




Importi sipas Broad Economic Categories (BEC) - (TM3/2023)

Vlera në (000)

Forma tabelare:

	1: Ushqim dhe pije	2: Furnizimet industriale të paspecifikuara diku tjetër	3: Karburantët dhe lubrifikantët	4: Mallrat kapitale (përveç pajisjeve të transportit) me pjesët dhe aksesoret e saj	5: Pajisjet e transportit me pjesët dhe aksesoret e tyre	6: Mallrat e konsumit të paspecifikuara diku tjetër	7: Mallrat të cilat nuk janë të specifikuar diku tjetër
2023M09	86 596,808	152 529,967	80 741,325	58 465,643	52 919,356	94 508,428	1 279,354
2023M08	97 112,463	151 019,086	76 761,892	53 980,065	51 878,459	90 357,480	2 044,390
2023M07	96 737,471	143 038,313	63 801,511	57 461,409	58 269,604	92 178,339	568,114

Forma grafike:



(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Cilat janë vendet më konkurruese me talente?

Shkolla franceze e biznesit INSTEAD ka hulumtuar konkurrencën e talentëve të vendeve që nga viti 2013, dhe sapo ka publikuar edicionin e 10-të të Indeksit të Konkurrueshmërisë së Talenteve Globale. Indeksi i vitit 2023 rendit 134 vende, në të gjitha grupet e të ardhurave, për performancën e talentëve të tyre për të ndihmuar vendet të krijojnë politika dhe të bëjnë veprime për përmirësim.

Zvicra renditet si vendi më i mirë në botë për tërheqjen dhe edukimin e talentëve për të dhjetin vit radhazi, e ndjekur nga afër nga Singapori dhe Shtetet e Bashkuara.

Danimarka, Holanda, Finlanda, Norvegjia, Australia, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar janë 10 vendet tjera kryesore për konkurrencën e talentëve.

Evropa dominon indeksin me 17 vende në 25 vendet e para. Gjithashtu në 25 vendet e para janë Australia, Kanadaja, Zelanda e Re, Emiratet e Bashkuara Arabe, Koreja e Jugut dhe Izraeli.

Veçanërisht, ky vit shënon herën e parë që Japonia nuk ka hyrë në top 25 – ajo është zëvendësuar nga Koreja e Jugut.


Niveli i pagës mesatare në Kosovë

Vlera në euro

Forma tabelare:

	Paga mesatare		Sektori Publik		Ndërmarrjet Publike		Sektori Privat	
	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto
2022	521	446	604	536	789	659	473	401

Forma grafike:



(Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës)

BQK

Prezantimi vjetor për vitin 2023

"Sistemi financiar në vend është i qëndrueshëm, stabil, likuid dhe mirë i kapitalizuar, cilësia e aseteve është adekuate. Ndërmjetësimi financiar është rritur, ndërsa qasja në financa ka nevojë të zgjerohet, me theks me atë në kushte sa më konkurruese dhe të përballeshme",- ka theksuar Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Ahmet Ismaili, gjatë prezantimit vjetor para medieve, e organizuar në prag të fundvitit.

Sa i përket treguesve makroekonomikë, rritja ekonomike në Kosovë sipas BQK-së në vitin 2023 pritet të jete 3.4 për qind, derisa për vitin 2024, pritet një rritje më e lartë prej 4.2 për qind, mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme dhe eksporti. Gjithashtu,

projeksionet e BQK-së për shkallën e inflacionit në tremujorin e fundit sugjerojnë për një ngadalësim të ritmit në 2.9 për qind, ndërkohë që mesatarja e vitit 2023 pritet të jetë 5.1 për qind.

Lidhur me eksportin dhe importin e mallrave e shërbimeve, i pari i BQK-së ka shtuar se për periudhën janar-shtator 2023 vlera e importeve ka arritur në 5 miliardë e 271 milionë euro, kurse e eksporteve ishte 3 miliardë e 61 milionë euro.



"Bilanci tregtar i shërbimeve, vazhdimisht ishte pozitiv dhe deri në shtator 2023 shënoi vlerën 1 miliardë e 398 milionë euro (2,419.9 - 1,021.5) që është për 20.8 për qind më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 që ishte 1 miliard e 158.1 milionë euro (2,040.6 - 882.6). Eksporti i shërbimeve për periudhën janar shtator 2023 arriti vlerën prej 2.4 miliardë euro, duke u rritur për 19 për qind, krahasuar me përudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rol kyç në këtë rritje të kësaj kategorie patën të hyrat nga shërbimet e udhëtimit, shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit që kanë shënuar rritje të vazhdueshme në vitet e fundit", - shtoi Guvernatori Ismaili. Po ashtu, ai ka treguar se është hera e parë që dërgesat e mërgatës, deri më muajin nëntor 2023, tejkaluan vlerën prej 1.2 miliard eurove. Ndërsa, investimet e Huaja Direkte, deri në fund të tremujorit të tretë 2023, kanë arritur vlerën e 621.3 milionë eurove, prej të cilave 368.8 milionë euro janë në sektorin e patundshmërisë.

(Burimi: BQK)

FONDI SOVRAN I PASURISË (FSP)

Fondi sovran i pasurisë është fond investimi në pronësi të shtetit, që menaxhon dhe investon rezervat e një vendi, që zakonisht rrjedhin nga të ardhurat e tepërta. Financimi i këtij fondi mund të vijë nga burime të ndryshme, duke përfshirë të ardhurat nga burimet natyrore, tepricat tregtare, rezervat bankare, operacionet në valutë të huaj, paratë nga privatizimet dhe transfertat qeveritare. Pra, kur një vend ka një suficit në llogarinë rrjedhëse dhe grumbullon rezerva mbi nevojat e tij të menjëhershme, mund të vendosë të krijojë një fond sovran për të menaxhuar këto burime shtesë.

Qëllimi dhe objektivat

Fondet sovranë të pasurisë krijohen me qëllime specifike, shpesh të fokusuara në maksimizimin e të ardhurave, stabilizimin e ekonomisë ose financimin e detyrimeve të ardhshme si pensionet. Disa vende i përdorin këto fonde për të zbutur ndikimin e luhatjeve ekonomike, ndërsa të tjerët i përdorin ato për të mbështetur industritë vendase ose projektet strategjike.

Strategjitë e investimeve

FSP-të përdorin strategji të ndryshme investimi bazuar në objektivat e tyre dhe tolerancën ndaj rrezikut. Disa fonde fokusohen në strategji pasive, të tilla si gjurmimi i indekseve, ndërsa të tjerët menaxhojnë në mënyrë aktive portofolet e tyre, duke u angazhuar në investime direkte, blerje ose partneritete për të rritur kthimet.

Transparenca dhe qeverisja

Niveli i transparencës dhe qeverisjes që lidhet me fondet sovranë të pasurisë ndryshon në vende të ndryshme. Shumë fonde funksionojnë me përkushtim ndaj transparencës, duke shpalosur strategjitë e tyre të investimit dhe performancën financiare për publikun. Praktikrat e qeverisjes shpesh përfshijnë menaxhimin e rrezikut, udhëzimet etike të investimeve dhe mekanizmat e llogaridhënies.

Sfidat dhe konsideratat

Fondet sovranë të pasurisë përballen me sfida që lidhen me ndërhyrjet politike, paqëndrueshmërinë ekonomike dhe konsideratat etike. Arritja e një ekuilibri midis maksimizimit të fitimeve dhe përafrimi i investimeve me interesat kombëtare është një sfidë e vazhdueshme për shumë FSP.

Fondet më të mëdha sovranë


Fondet më të mëdha sovranë në botë janë: Government Pension Fund Global – Norvegji, Abu Dhabi Investment Authority – Abu Dhabi, China Investment Corporation – Kinë, Kuwait Investment Authority – Kuvajt, SAMA Foreign Holdings – Arabia Saudite.

STATISTIKA / SHQIPËRI

PBB

Tremujori 3 - 2023

3,46 %



Inflacioni

Dhjetor 2023


4,0 %



Import/Eksport

Nëntor 2023

Shkalla e papunësisë



Forcat e Punës

Shkalla e papunësisë, T3-2023

10,5%



(Burimi: Instituti i Statistikave "Instat", Shqipëri)

STATISTIKA / GJERMANI

Bruto Produkti Vendor (BPV) - TM3/2023

Viti/TM		me çmimet aktuale (miliardë euro)		çmimi i rregulluar chain-linked index (2015=100)	
		Vlerat origjinale	vlera e rregulluar kalendarike dhe sezonale duke përdorur X13 JDemetra+	Vlerat origjinale	vlera e rregulluar kalendarike dhe sezonale duke përdorur X13 JDemetra+
2023	III	1,035.27	1,033.02	108.31	107.87
	II	1,009.82	1,025.16	106.30	108.01
	I	1,006.63	1,008.96	108.24	107.86

(Burimi: Statistisches Bundesamt (Destatis))

Tregtia e jashtme

Eksporti

Mn EURO

Viti/muaji		Gjithsej eksporte	Industria e ushqimit (të gjitha së bashku)	Tregti dhe industri			
				Të gjitha së bashku	Lëndë e parë	Produkte gjysmë të gatshme	Produkte të gatshme
2023	Tetor	130,894	8,010	117,968	888	6,422	110,658
	Shtator	129,262	7,570	116,753	974	6,702	109,077
	Gusht	123,770	7,987	111,986	944	6,571	104,471
	Korrik	126,108	7,494	113,830	827	6,526	106,477
	Qershor	139,309	8,190	127,856	1,009	6,896	119,950
	Maj	131,314	8,033	120,624	1,158	6,652	112,813

(Burimi: Statistisches Bundesamt (Destatis))



Importi

Mn EURO

Viti/muaji		Gjithsej eksporte	Industria e ushqimit (të gjitha së bashku)	Tregti dhe industri			
				Të gjitha së bashku	Lëndë e parë	Produkte gjysmë të gatshme	Produkte të gatshme
2023	Tetor	112,849	9,008	94,460	8,153	7,064	79,242
	Shtator	110,056	8,586	92,295	6,956	7,338	78,001
	Gusht	107,808	9,111	91,069	7,102	7,343	76,625
	Korrik	108,101	8,720	91,871	7,712	7,493	76,666
	Qershor	117,218	9,699	100,604	6,850	8,036	85,717
	Maj	117,891	9,940	100,926	8,461	8,219	84,246

(Burimi: Statistisches Bundesamt (Destatis))

8 shkathtësi udhëheqëse për t'u zhvilluar

Udhëheqja nuk është një cilësi që ju nuk e posedoni ose ju mungon në mënyrë të lindur; është shuma e tetë aftësive që mund të zhvilloni me kalimin e kohës:

Autenticiteti. Punoni për të ndërtuar vetëdijen dhe vendoseni veten në pozicione për të nxjerrë në pah pikat tuaja të forta dhe për të përmirësuar dobësitë tuaja.

Kurioziteti. Bëni pyetje për atë që nuk dini. Mendoni gjerësisht dhe me ambiciozitet. Paraqituni si dikush që vazhdimisht dëshiron të mësojë, eksplorojë dhe inovojë.

Të menduarit analitik. Udhëheqja kërkon aftësinë për të zbërthyer problemet komplekse, për të identifikuar shkaqet kryesore të tyre dhe për të gjetur zgjidhje të reja. Zhvilloni aftësitë tuaja analitike duke u fokusuar në marrëdhëniet shkak-pasojë dhe duke qenë të vëmendshëm ndaj modeleve dhe tendencave.

Përshtatshmëria. Merrni përsipër detyra dhe kërkon përvija që kërkojnë fleksibilitet. Shtyjeni veten për të punuar në mjedise të reja me lloje të ndryshme njerëzish.

Kreativiteti. Ju nuk keni nevojë domosdoshmërisht të krijoni çdo ide të shkëlqyer vetë. Ndonjëherë ka të bëjë me krijimin e një mjedisi që ushqen kreativitetin tek të tjerët.

Rehati me paqartësi. Menaxhimi i paqartësisë ka të bëjë me mbajtjen e ideve kontradiktore në kokën tuaj dhe trajtimin e prioriteteve konkurruese që ndihen po aq të rëndësishme. Pyetni shumë "çka nëse" dhe "pra çfarë është" dhe shqyrtoni çështjet nga këndvështrime të ndryshme.

Qëndrueshmëria. Kur gjërat bëhen të vështira, shfaqni elasticitetin për të rikalibruar, rigrupuar dhe për të marrë të dhëna nga të tjerët duke pyetur: "A ka një rrugë tjetër?"

Empatia. Zhvillimi i inteligjencës suaj emocionale ju jep një vlerësim më të thellë të sfidave komplekse që të tjerët po përballojnë – dhe ju ndihmon të krijoni një mjedis më mbështetës dhe edukues.



Gjetjet kryesore të Raportit të vitit 2023 në fushën e ekonomisë

Sa i përket kriterëve ekonomike, Kosova ka bërë njëfarë progresi dhe është ndërmjet një faze të hershme dhe një niveli të përgatitjes për zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale. Rimëkëmbja ekonomike e Kosovës u frenua ndjeshëm në vitin 2022. Kjo ishte kryesisht për shkak të zvogëlimit të investimeve dhe ngadalësimit të rritjes së konsumit të familjeve, si pasojë e inflacionit të lartë, veçanërisht pas fillimit të luftës, si pasojë e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës. Pavarësisht elasticitetit që ekonomia ka demonstruar gjatë krizave të fundit, sektori privat vazhdon të pengohet nga sfidat strukturore të gjata, të tilla si një ekonomi joformale e përhapur, një prani e lartë e korrupsionit dhe, në përgjithësi, sundimi i dobët i ligjit.

Rritja e lartë e të ardhurave për shkak të rritjes së çmimeve dhe rritjes së numrit të njerëzve në punë formale, dhe një nënëkzekutim i konsiderueshëm i shpenzimeve kapitale publike, çuan në një buxhet pothuajse të balancuar në vitin 2022, ndërkohë që raporti i borxhit publik ra. Inflacioni u rrit në dyshifrorë për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë, ushqimeve dhe transportit, duke çuar në rritje të deficitit. Sektori financiar mbeti i mirëkapitalizuar dhe i qëndrueshëm, ndërkohë që kreditimi bankar vazhdoi të zgjerohej.

Kosova ka bërë përparim të kufizuar dhe është në një fazë të hershme sa i përket kapacitetit të saj për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut në BE. Sistemi arsimor nuk mëson mjaftueshëm aftësitë e nevojshme kyçe dhe nuk është në përputhje adekuate me nevojat e tregut të punës. Kosova bëri përpjekje në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe rritjen e investimeve në burimet e rinovueshme, por furnizimi me energji me bazë qymyri, i vjetruar dhe jo i besueshëm mbetet shqetësim. Kosova ka bërë disa përparime në digjitalizimin e ekonomisë.

Është bërë progres i kufizuar gjatë periudhës raportuese në fushat e prokurimit publik dhe kontrollit financiar. Sa i përket statistikave, ka pasur disa përparime.

TË ECIM BASHKË!

Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane është organizatë jofitimprurëse e themeluar në Gjermani, në tetor të vitit 2013. Ajo funksionon si shoqatë ombrellë e bizneseve dhe ofron një numër të madh shërbimesh në funksion të zhvillimit të tyre.

Unioni është rrjet i përhershëm i bizneseve dhe shërben si platformë e vazhdueshme për nxitjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet kompanive anëtare, stimulimin dhe lehtësimin e investimeve të jashtme direkte, përmirësimin e qasjes në financa dhe lehtësimin e eksporteve për kompanitë me bazë në Kosovë, përmes krijimit të urave të bashkëpunimit me bizneset e diasporës. Gjatë një dekade të veprimit të tij, Unioni ka arritur rezultate të dukshme si në kuadër të misionit të tij kryesor – nxitjes dhe lehtësimit të bashkëpunimit midis anëtarëve, ashtu edhe në ofrimin e kontributit për zhvillimin ekonomik, mbështetjes humanitare dhe atë të ngritjes së cilësisë së arsimit në vendet e origjinës.

Ne nuk do të ndalemi. Synimi ynë është e kundërta – rritja dhe shpejtimi i hapave. Por, këtë mund ta bëjmë vetëm nëse rritemi edhe vetë ne, sa më shpejtë. Dhe, pikërisht kjo është arsyeja pse ne kemi nevojë edhe për ju. Të ecim bashkë, të rritemi bashkë, të ecim më shpejtë!

Katalogu i përfitimeve të anëtarit

28+ PËRFITIME

	 PREMIUM	 GOLD	 SILBER	 BRONZE
Krijimi i profilit të biznesit në platformë	●	●	●	●
Qasje në profilet e bizneseve anëtare të Unionit	●	●	●	●
Publikimi i projekteve nga anëtarët e Unionit	●	●	●	●
Pjesëmarrje në trajnime dhe punëtori	● x2	●	●	●
Njoftim për mundësitë e investimeve në projekte në vendet e origjinës / publike dhe private	●	●	●	●
Takime PREMIUM – takime mëngjesi/darke i anëtarëve Premium	●	●	●	●
Konsulencë ligjore në fushën e investimeve, rreth tatimeve dhe për investime përmes PPP (Kosovë)	●	●	●	●
Mundësi aplikimi për fonde investimi	●	●	●	●
Njoftim i vazhdueshëm me risitë në politikat fiskale dhe ekonomike në vendlindje	●	●	●	●
Partneritet midis anëtarëve për investime të përbashkëta (konzorcium, shoqëri aksionare etj.)	●	●	●	●
Adresim i çështjeve të veçanta të investitorëve, anëtarë të Unionit, pranë institucioneve shtetërore	●	●	●	●
Lobim tek institucionet shtetërore për ndryshimin e ligjeve apo politikave fiskale	●	●	●	●
Ndihmë në identifikimin e bashkëpunëtorëve potencial / lehtësim në krijimin e lidhjes	●	●	●	●
Mundësi aplikimi për projekte investimi	●	●	●	●
Njoftim për mundësitë e marrjes së granteve nga institucionet shtetërore dhe organizatat e huaja	●	●	●	●
Qasje në raportet vendore e ndërkomb. për ekonominë dhe të bërit biznes në vendlindje (publikim)	●	●	●	●
Vizita të organizuara në panaire	● x2	●	●	●
Ofertë për bashkëpunim nga anëtarët e Unionit	●	●	●	●
Pjesëmarrje në takime B2B (Business to Business)	● x2	●	●	●
Njoftim për aktivitetet që organizohen nga partnerët e Unionit	●	●	●	●
Ndihmë teknike për vetorganizimin e aktiviteteve me anëtarë të caktuar të Unionit	●	●	●	●
Reklamim i bizneseve anëtare në platformën digjitale dhe rrjetet sociale të Unionit	●	●	●	●
Info. dhe statistika rreth indikatorëve makroekonomik, eksport-import dhe investimeve të jashtme	●	●	●	●
ANËTARI PËR ANËTARIN (anëtar i Unionit përfiton zbritje nga anëtarët e tjerë)	●	●	●	●
PRIVILEGJI I ANËTARIT (Oferta speciale për anëtarë nga marrëveshjet që lidh Unioni me subjektet e treta ekonomike)	●	●	●	●
Marrja e referencave bazuar në performancën në platformë	●	●	●	●
Mundësi për t'u bërë/për të gjetur distributor/agent tregtar	●	●	●	●
Pjesëmarrje në bashkëbisedim me personalitete të rëndësishme	●	●	●	●

Shërbime që aktivizohen pas lansimit të platformës digjitale



ARSYET PËR TË INVESTUAR NË KOSOVË

Për kompanitë që kërkojnë të investojnë në një vend me shpenzime të vogla e me qasje të lehtë në BE, në Evropën Qendrore dhe në tregjet e Ballkanit, Kosova paraqet një mundësi shumë atraktive.

Në Kosovë, një investitor mund të regjistrojë biznesin për 2 ditë, falas me zero kapital çarter (për SHPK-të).

Regjimi i tregut të lirë

- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian (BE);
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me BE-në (mbi 500 milion konsumatorë);
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Evropën Qendrore (CEFTA) (përfshinë 7 vendet jo-anëtare të BE-së: Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Moldavinë, Malin i Zi dhe Serbinë – popullsia: 21 milion);
- Programi i Sistemit të Gjeneralizuar të Preferencave (Generalized System of Preferences (GSP) Program) me SHBA-në, Japoninë dhe Norvegjinë.

Kosto e ulët e operimit

- Paga mesatare bruto në sektorin privat është 473 €;
- TVSH: 8% për produktet bazë (shërbimet dhe shporta e ushqimit) dhe 18% për produktet tjera;
- Tatimi në dividendë: 0%
- Liberalizimi i importit:
 - Linjat e prodhimit dhe pajisjet për prodhim
 - Lënda e parë për prodhim (që nuk prodhohet në Kosovë)
 - Pajisjet e teknologjisë informative (TI);
- Sistemi Elektronik i Prokurimit
- Tatimi në të Ardhurat e Korporatave: 10%
- Tatimi mbi të Ardhurat Personale: 0 – 10 % (progresive)
- Kontributi pensional i detyruar: 5%

Sektorët që ofrojnë më shumë mundësi për investitorët e jashtëm janë:

- Bujqësia dhe Përpunimi i Ushqimit
- Përpunimi i drurit
- Ndërtimi
- Tekstili
- TI
- Komponentët e automobilave
- Turizmi
- Energjia dhe minierat

(Burimi: KIESA dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës)


ANÄTARË PREMIUM+



AD Bau GmbH & Co KG
Hoch - und Tiefbau



METALLBAU
Ihr kompetenter Partner in Stahl und Edelstahl



Hajdari



**Hotel
Neuenahrer Hof**



**Sami Hyseni
Consulting**



2B Projektentwicklung GmbH

Profili i anëtarëve

Shërbime	47.60 %
Ndërtimtari	35.46 %
Gastronomi	5.75 %
Tregti	2.24 %
Prodhim	3.83 %
Financa	2.88 %
Shëndetësi	1.60 %
Veshmbathje	0.64 %

Zotimi i bordit

“Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane do të jetë një urë e sigurt dhe një zë i fortë për anëtarët tanë, si në procesin e bashkëpunimit midis tyre, ashtu edhe në përfaqësimin e tyre në institucione, shoqata dhe kompani, në Gjermani dhe në vendet tona të origjinës”.



ZYRA QENDRORE - GJERMANI

Tel. +49 (0) 211 88 250 220, +49 152 247 562 80

ZYRA NË KOSOVË

Tel. +383 48 735 734

info@union-business.de, www.union-business.de



“Njerëzit shpesh thonë se motivimi nuk zgjat. Epo, as larja nuk zgjat- kjo është arsyeja pse ne e rekomandojmë atë çdo ditë”.

Zig Ziglar



Paçi shëndet dhe suksese, në punë e në jetë!